



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 56, datë 3.8.2018

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.41, DATË 04.06.2018, “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 2 DATË 21.02.2008 “PËR REGJISTRIMIN DHE ADMINISTRIMIN E EMRAVE TË DOMAINEVE NËN .AL DHE NËNDOMAINET .GOV.AL, .MIL.AL, .EDU.AL, .COM.AL, .ORG.AL DHE .NET.AL””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- |                 |          |         |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Ilir      | Zela     | Kryetar |
| 2. Z. Alban     | Karapici | Anëtar  |
| 3. Znj. Edlira  | Dvorani  | Anëtar  |
| 4. Znj. Ketrin  | Topçiu   | Anëtar  |
| 5. Znj. Klarina | Allushi  | Anëtar  |

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 03.08.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyroi çështjen me objekt:

**“Shtyrjen e fillimit të pasojave juridike të vendimit të Këshillit Drejtues nr.41, datë 04.06.2018, dhe akteve rregullatore të miratura me këtë vendim, nga data 1 shtator 2018, në datën 1 nëntor 2018”**

**BAZA LIGJORE:**

1. Pika 1, e nenit 114, dhe pika 1, neni 115, të Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji 9918/2008*);

2. Pika 3, Neni 104, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (*ligji44/2015*);
3. Rregullore Nr.2 datë 21.02.2008 për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domaineve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, e ndryshuar;

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacionin shoqërues të projektvendimit;
2. Projekt Vendimi i arsyetuar dhe formatuar;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr.41, datë 04.06.2018, ka miratuar dokumentet si më poshtë:

- A. *Disa shtesa dhe ndryshime të Rregullores nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar;*
- B. *Listë e emrave të rezervuar;*
- C. *Listë e emrave të ndaluar.*
- D. *Qëndrimi i AKEP dhe komentet e palëve të interesuara mbi disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar;*

Në dispozitivin e këtij vendimi, Këshilli Drejtues i AKEP, duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të Vendimit nr.41, datë 04.06.2018, me qëllim që ndryshimet në këtë akt rregullator të kontribuojnë në rritjen e transparencës ndaj publikut të rregullave të AKEP për domainet .al dhe nëndomainet, regjistrimin e domaineve .al dhe nëndomaineve në afate të shkurtra dhe të përcaktuara qartë, vendosjen e disa kushteve të nevojshme në Rregulloren Nr. 2 për mbarëvajtjen e procesit të veprimeve me domainet .al dhe nëndomainet, njohjen dhe implementimin në Rregulloren Nr. 2 të drejtës së poseduesit të domain .al dhe nëndomaineve për transferimin e domainit nga një Regjistruer tek një tjetër Regjistruer, miratimin e listës së domaineve të rezervura dhe domaineve të ndaluara, e të tjera, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuara në shkronjat k), p) dhe s) të nenit 8, nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në referim dhe me pikën 3, të nenit 104, të Ligjit 44/2015, ka përcaktuar fillimin e efekteve të zbatimit të Vendimit nr.41, datë 04.06.2018, nga data 1 shtator 2018.

Ndaj këtij vendimi janë paraqitur pranë AKEP, dy ankesa administrative, nga subjekte regjistruer, të cilat janë paraqitur brenda afateve ligjore dhe plotësojnë kushtet e pranimit

sipas nenit 132 dhe 135 të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Në këto kushte, Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për shkak të kompleksitetit faktik që paraqet çështja, si dhe me qëllim shqyrtimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të pretendimeve dhe parashtrimeve të subjekteve në lidhje me ankimet administrative ndaj Vendimit nr.41, datë 04.06.2018, në mbështetje të nenit 140 të ligjit 44/2015, gjykon të nevojshëm shtyrjen e efektit të fillimit të pasojave juridike të Vendimit nr.41, datë 04.06.2018, si dhe akteve rregullatore të miratura me këtë vendim, deri në shqyrtimin e plotë dhe shterues të pretendimeve të ngritura në ankimet administrative të paraqitura nga subjektet regjistruar “WebHost sh.p.k” dhe “Shqipëriacom sh.p.k”.

#### **PËR KETO ARSYE:**

Bazuar në nenin 104 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 114, dhe 115, të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

#### **V E N D O S:**

1. Ndryshimin e pikës 3 të Vendimit nr.41, datë 04.06.2018, dhe shtyrjen e fillimit të efekteve të zbatimit të këtij vendimi, dhe akteve rregullatore të miratuara, nga data 1 shtator 2018, **në datën 1 nëntor 2018.**
2. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**KRYETAR**

**Ilir Zela**

#### **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Edlira DVORANI
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI